AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA


Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjeve Ekonomike në Kosovë, Shtator 2026

30.10.2026
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Repertorin Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë për muajin shtator 2026.

Rritje prej 24,5 % e ndërmarrjeve të regjistruara në shtator 2026

Gjatë muajit shtator 2026, gjithsej janë regjistruar 1 259 ndërmarrje, duke shënuar rritje prej 24,5 %, krahasuar me muajin gusht 2026. Ndërkaq, një rritje prej 19,4 % krahasuar me shtatorin e vitit 2025.

Karakteristikat e ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara




Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas sektorëve

Aktivitetet ekonomike me numrin më të madh të regjistrimeve gjatë muajit shtator ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, me 317 ndërmarrje të

regjistruara (25,2 %) të numrit të përgjithshëm; Aktiviteti i prodhimit, me 138 ndërmarrje (11,0 %); dhe Aktivitetet shërbimeve të tjera, me 129 ndërmarrje (10,2 %).

Ndërmarrjet e reja sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike Shtator 2026 / Shtator 2025




Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas kategorisë

Sa i përket klasifikimit sipas numrit të të punësuarve në muajin shtator 2026, pjesën dërrmuese të ndërmarrjeve të regjistruara e përbëjnë mikro ndërmarrjet.

Nga gjithsej 1 259 ndërmarrje të regjistruara, 1 250 i përkasin kategorisë së mikro ndërmarrjeve, me 0 deri në 9 të punësuar dhe 9 ndërmarrje i përkasin kategorisë së ndërmarrjeve të vogla, me 10 deri në 49 të punësuar. Gjatë këtij muaji nuk është regjistruar asnjë ndërmarrje në kategorinë e ndërmarrjeve të mesme, me 50 deri në 249 të punësuar, ose në kategorinë e ndërmarrjeve të mëdha, me 250 e më shumë të punësuar.

Këto të dhëna tregojnë se regjistrimet e reja gjatë shtatorit janë përqendruar pothuajse tërësisht në kategorinë e mikro ndërmarrjeve.




Shpërndarja gjeografike e ndërmarrjeve të regjistruara

Në aspektin e shpërndarjes gjeografike, Rajoni i Prishtinës prin me numrin më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara, me gjithsej 635 ndërmarrje, që përbëjnë 50,4 % të totalit. Pastaj, Rajoni i Prizrenit: 126


ndërmarrje (10,0 %); Rajoni i Ferizajt: 120 ndërmarrje (9,5 %); Rajoni i Mitrovicës: 102 ndërmarrje (8,1 %); Rajoni i Pejës: 94 ndërmarrje (7,5 %); Rajoni i Gjakovës: 91 ndërmarrje (7,2 %) dhe Rajoni i Gjilanit: 91 ndërmarrje (7,2 %).

Të dhënat tregojnë se Rajoni i Prishtinës vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të madhe në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara, duke përfaqësuar më shumë se gjysmën e regjistrimeve të përgjithshme gjatë muajit shtator 2026.

Struktura e ndërmarrjeve të reja sipas rajoneve Shtator 2026 / Shtator 2025



Ndërmarrjet e reja sipas formës ligjore e organizimit në %



Për më shumë informata lidhur me publikimin e Repertorit Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë për muajin shtator 2026, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Publication